



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË**

V E N D I M

Nr. 3 Datë 02 02 2007

**PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE PAGAVE
TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE VARTËSE TË SAJ PËR
VITIN 2007**

(KLUBI I FUTBOLLIT "SKËNDERBEU")

Mbështetur në Ligjin Nr.8652 ,datë 31.07.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore..." neni 44 "Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Komunës ose Bashkisë" neni 32 gërma "dh", në Ligjin Nr 7776 datë 22.12.1993 "Për buxhetin lokal", ndryshuar me Ligjin Nr.8399, datë 09.09.1998 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.7776. Datë 22.12.1993 "Për buxhetin lokal" në Ligjin 8379 Datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", te ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Per buxhetin e shtetit te vitit 2007", në Udhëzimin Nr.2 datë 17.01.2007 të Ministrisë së Financave, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 551 datë 07.11.2002 "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", ndryshuar me V.K.M Nr.355 datë 14.06.2006 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.551, Datë 7.11.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, e përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore , të ndryshuar" si dhe diskutimet e këshilltarëve ,Këshilli i Bashkisë:

V E N D O S I :

1.Të miratohet struktura dhe pagat e Bashkisë Korçë dhe institucioneve vartëse të saj për vitin 2007 si më poshtë.

(KLUBI I FUTBOLLIT "SKËNDERBEU")

Nr.	EMËRTIMI I POZICIONIT	Nr.fizik i personave	Kategoria	Paga bazë	Shtesa pozicion	Kategoria fikse
a.	b.	c.		d.	e.	f.
1.	Sekretar klubi	1	III.b	10050	26712	
2.	Pergjegjëse finance	1	III.b	10050	23373	
3.	Magaziniere arketare	1	P.15			26712
4.	Punetor mirembajtje fushe	2	P.16			19366
5.	Punetore	3	P.16			19366
	T o t a l i	8				

2.Të gjitha përcaktimet e mëparëshme për pozicionet e punës që bien në kundërshtim me përcaktimet në këtë urdhër,shfuqizohen.

3.Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Drejtoria e Personelit, Protokoll Arkivit dhe Mbështetjes, si dhe Drejtoria e Financës në Bashki Klubi i Futbollit "Skënderbeu"

4.Efektet financiare të këtij vendim fillojnë nga data **01.01.2007**.

5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K r y e t a r i

Gjergji MERO



Dixhitalizuar nga Qendra e
www.infocip.org